

Biografi e shkurtër

Irini Shira, këshilltare ligjore

Znj. Irini Shira është diplomuar “Jurist” në vitin 2007 pranë Fakultetit të Drejtësisë në universitetin “Luarasi”.

Pas studimeve, është angazhuar në fushën e avokatisë dhe është anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë që nga viti 2007. Nga marsi i vitit 2015 ka punuar si “Jurist” në struktura të sigurisë dhe mbrojtjes, pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe më pas, që prej vitit 2019 ka qenë pjesë e stafit të Kabinetit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në pozicionin e Këshilltarit Ligjor.

Gjatë përvojës së saj profesionale ka marrë pjesë në shumë aktivitete trajnuese brenda dhe jashtë vendit që lidhen kryesisht me aspektet ligjore kundër korrupsionit, mbi mbështetjen e autoriteteve në fushën e mbrojtjes si dhe mbi politikat evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes.

Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe ka njohuri të mira në gjuhën greke, franceze dhe italiane.

Aktualisht, është pjesë e strukturës së Njësisë Ligjore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me detyrë “Këshilltare Ligjore”.